

L I G J
Nr.8461, datë 25.2.1999

PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003; nr. 9206, datë 17.6.2004; nr. 9387, datë 4.5.2005; nr. 9447, datë 24.11.2005; nr. 9576, datë 3.7.2006)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë arsimi i lartë është publik dhe jopublik.

Arsimi i lartë publik garantohej dhe financohet nga shteti, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Arsimi i lartë publik është laik.

Neni 2

(Shtuar togfjalësh me ligjin nr. 9387, datë 4.5.2005)

Misioni i arsimit të lartë civil është:

a) të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë e të transmetojë dijet me anën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, të zhvillojë dhe të çojë përpara artet, edukimin fizik dhe sportet;

b) të formojë specialistë të lartë;

c) të përgatisë shkencëtarë të rinj.

Arsimi i lartë i strukturave të Forcave të Armatosura, si dhe i strukturave të tjera që kanë statusin e ushtarakut, ka për mision të formojë, të përgatisë e të kualifikojë oficerë dhe specialistë të lartë si edhe shkencëtarë të rinj, të aftë e të përkushtuar në mbrojtjen e Atdheut dhe në zbatimin e detyrave që përcaktohen me ligj.

Arsimi i lartë i policisë ka për mision të formojë, të përgatisë e të kualifikojë specialistë të aftë e të përkushtuar për mbrojtjen dhe sigurinë publike.

Neni 3

Arsimi i lartë civil kryhet në shkollat e larta universitare dhe në shkollat e larta jouniversitare. Shkollat e larta universitare dhe jouniversitare më poshtë do të quhen “shkolla të larta”.

Arsimi i lartë i strukturave të Forcave të Armatosura, atyre të policisë, si dhe i strukturave të tjera që kanë statusin e ushtarakut, kryhet në shkollat e larta përkatëse, të cilat më poshtë do të quhen “shkolla të larta ushtarake ose të policisë”.

Neni 4

Shkollat e larta dhe shkollat e larta ushtarake ose të policisë janë persona juridikë. Shkollat e larta drejtohen dhe përfaqësohen nga rektori ose drejtori.

Shkollat e larta ushtarake ose të policisë drejtohen dhe përfaqësohen nga komandanti ose drejtori.

Neni 5

Shkollat e larta universitare janë institucione mësimore-shkencore që kanë për detyrë:

a) të realizojnë arsimimin profesional dhe formimin shkencor, nëpërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor;

b) të kryejnë studime shkencore në fushat që mbulojnë dhe të përgatisin shkencëtarë të rinj.

Shkollat e larta jouniversitare janë institucione mësimore dhe detyrë kryesore kanë përgatitjen e specialistëve me kualifikim të lartë.

Neni 6

Shkollat e larta kanë liri akademike në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Liria akademike qëndron në respektimin e opinioneve, të ideve e metodave dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor, në përputhje me planet dhe programet përkatëse.

Neni 7

Shkollat e larta publike civile janë institucione autonome. Në këtë kuadër:

a. shkolla e lartë zgjedh organet dhe autoritetet e veta drejtuese;

b. personeli i shkollës së lartë ka të drejtë të zgjedhë e të zgjidhet në organet drejtuese të shkollës së lartë në përputhje me statusin e shkollës së lartë;

c. shkolla e lartë përcakton fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor;

ç. shkolla e lartë përzgjedh personelin e vet;

d. buxheti i çdo shkolle të lartë publike është zë më vete në buxhetin për arsimin dhe administrohet prej saj sipas rregullave të përcaktuara me akte ligjore. Buxheti i shkollave të larta ushtarake ose të policisë është zë më vete në buxhetin e ministrisë përkatëse;

dh. shkolla e lartë ka të drejtë të ofrojë shërbime në fushat që kanë lidhje me aspektet e zbatimit praktik të mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe të realizojë të ardhura prej tyre;

e. shkolla e lartë ka të drejtë të lidhë marrëveshje me shkollat e larta të huaja për shkëmbim përvoja dhe për bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor, si dhe për

kualifikimin e personelit;

ë. shkolla e lartë ka të drejtë të vendosë marrëdhënie dhe të anëtarësohet në shoqata ose organizata ndërkombëtare të arsimit të lartë;

f. shkolla e lartë ka të drejtë të bashkëpunojë me subjekte, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë.

Neni 8

*(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe shtuar paragraf me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003;
ndryshuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 9387, datë 4.5.2005)*

Shkollat e larta ushtarake ose të policisë kanë të drejtë të përzgjedhin personelin e tyre mësimdhënës e drejtues, të cilin ia propozojnë për miratim ministrisë përkatëse.

Titullari i universitetit ushtarak emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, nga radhët e oficerëve madhorë ose të civilëve, me titull a gradë shkencore, ndërsa titullari i Akademisë së Policisë emërohet në përputhje me ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Universiteti ushtarak është institucion arsimor në varësi të strukturave hierarkike të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa Akademia e Policisë është institucion arsimor në varësi të strukturave hierarkike të Ministrisë së Rendit Publik.

Shkollat e larta ushtarake ose të policisë kanë të drejtë të vendosin marrëdhënie me shkollat simotra të huaja për shkëmbim përvoja e bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor, në kualifikimin e kuadrit, si dhe të marrin pjesë në shoqata dhe organizata ndërkombëtare, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara ose të miratuara nga ministria përkatëse.

Neni 9

Shteti garanton paprekshmërinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe të territorit të tyre.

Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesën ose me lejen e titullarit të shkollës së lartë. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e titullarit të shkollës së lartë.

Cenimi i paprekshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë ndëshkohet sipas dispozitave ligjore.

Neni 10

Vlerësimi i cilësisë së shkollave të larta dhe akreditimi akademik kryhen nga Agjencia e Akreditimit dhe Këshilli i Akreditimit. Krijimi dhe kompetencat e tyre përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 10/1

(Shtuar me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Në sistemin e arsimit të lartë funksionon Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës,

si organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për hartimin dhe realizimin e politikave të zhvillimit të arsimit dhe të shkencës.

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës ka këto detyra:

a) këshillon Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e arsimit të lartë dhe të shkencës për hartimin e strategjive e të programeve kombëtare për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;

b) këshillon Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për drejtimit e politikës së arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik;

c) sugjeron fushat parësore të kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik dhe programet kombëtare të kërkimit shkencor dhe zhvillimit;

ç) këshillon Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për arsimin e lartë, shkencën dhe zhvillimin teknologjik, me synim edhe përafrimin e tyre me legjislacionin e BE-së;

d) sugjeron kriteret për vlerësimin, akreditimin dhe riakreditimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, shkencës dhe zhvillimit teknologjik;

dh) Sugjeron kriteret e dhënies së gradave dhe të titujve shkencorë;

e) këshillon Ministrin e Arsimit dhe Shkencës edhe për çështje të tjera, që Ministri i vlerëson të rëndësishme.

Sugjerimet e bëra nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, për të cilat kërkohet miratimi i Këshillit të Ministrave, paraqiten për miratim nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Neni 10/2

Përbërja e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës

(Shtuar me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës përbëhet nga 19 veta si më poshtë:

- | | |
|---|------------|
| a) Ministri i Arsimit dhe Shkencës | - Kryetar |
| b) Kryetari i Akademisë së Shkencave | - anëtar |
| c) Kryetari i Konferencës së Rektorëve | - anëtar |
| ç) Një përfaqësues i caktuar nga Ministri i Financave | - anëtar |
| d) 15 përfaqësues, ekspertë të fushës së arsimit të lartë, shkencës, teknologjisë dhe sektorit privat | - anëtarë. |

Neni 10/3

Kriteret për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës

(Shtuar me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Anëtari i përcaktuar në shkronjën “d” të nenit 10/2 duhet të plotësojë këto kriteret:

a) të ketë dhënë kontribut në zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë, së paku, gradën “doktor shkencash”, të fituar me rezultatin “shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, si dhe të ketë, së paku, një përvojë pune 5-vjeçare, pas mbrojtjes së doktoratës, si pedagog apo bashkëpunëtor shkencor i brendshëm në shkollën e lartë ose në një qendër kërkimore;

c) të ketë qenë, së paku, pesë vjet pedagog ose bashkëpunëtor shkencor i brendshëm në shkollën e lartë ose në një qendër kërkimore gjatë 10 viteve të fundit;

ç) të ketë përvojë akademike ose kërkimore në qendra mësimore-kërkimore ndërkombëtare të njohura, pas marrjes së gradës “doktor shkencash”;

d) të ketë botuar shkrime origjinale në 10 vitet e fundit në revista shkencore të huaja, të njohura në indeksin shkencor ndërkombëtar (me impact-factor) dhe të ketë referuar në konferenca të rëndësishme shkencore europiane e më gjerë;

dh) të ketë kontribuar në përgatitjen e shkencëtarëve të rinj dhe të ketë udhëhequr të paktën një doktoratë;

e) të ketë treguar aftësi në konceptimin, hartimin dhe përgatitjen e strategjive në fushën përkatëse;

ë) të ketë treguar aftësi në planifikimin dhe drejtimin e punës kërkimoreshkencore në nivel ekspertësh.

Kriteri i përcaktuar në shkronjën “c” të paragrafit të mësipërm nuk zbatohet për kandidatët, që kanë përfunduar studime të plota doktorate në shkollat e larta të huaja të njohura, me rezultatin “shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”.

Ministri i Financave cakton si përfaqësues në Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës njërin ndër punonjësit e kësaj ministrie, i cili ka kualifikimin profesional dhe përvojën e duhur, të njëjtë me përfaqësuesit ekspertë.

Neni 10/4

Mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të tjerë të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës

(Shtuar me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Anëtarët e përcaktuar në shkronjën “d” të nenit 10/2 përzgjidhen nga fusha të ndryshme të shkencës, me konkurrim publik, nga një komision përzgjedhjeje, i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, i përbërë me një përfaqësues nga Kuvendi, një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe një përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve, të caktuar nga vetë këto institucione.

Komisioni i përzgjedhjes, pasi shqyrton plotësimin e kriterëve profesionale, në përputhje me këtë ligj, rendit në një listë kandidatët, sipas pikëve të fituara.

Këshilli i Ministrave emëron në detyrën e anëtarit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës 15 kandidatë, nga lista e paraqitur nga komisioni përzgjedhës.

Anëtarët e përcaktuar në shkronjën “d” të nenit 10/2 zgjidhen për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Në Këshillin e parë të Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH) pesë anëtarë të tij do të kenë mandat 3-vjeçar dhe pesë anëtarë të tjerë do të kenë një mandat 5-vjeçar. Përcaktimi i tyre do të bëhet me short. Në vijim mandati i anëtarëve të këtij Këshilli do të jetë 7-vjeçar.

Neni 10/5

Funksionimi i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës

(Shtuar me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Veprimtaria e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës ushtrohet në përputhje me rregulloren, që miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Në përputhje me rregulloren, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës mund të ngrejë edhe komisione e grupe pune të përkohshme ekspertësh, vendas apo të huaj, sipas fushave.

Për realizimin e detyrave, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës mbështetet nga një sekretariat teknik, i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, i cili është i përbërë nga punonjës të kësaj Ministrie.

Masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHKOLLAVE TË LARTA

Neni 11

(Shtuar paragrafë me ligjin nr. 9447, datë 24.11.2005)

Shkollat e larta universitare përbëhen nga fakultetet. Në raste të veçanta, brenda një shkolle të lartë universitare mund të përfshihet një shkolle e lartë jouniversitare, me strukturë të ngjashme me atë të një fakulteti.

Fakulteti është njësi mësimore-shkencore e shkollës së lartë universitare, që mbulon shkenca me trung të përbashkët.

Fakulteti dhe shkollat e larta jouniversitare përbëhen nga departamente.

Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore e shkollës së lartë universitare dhe njësi bazë mësimore e shkollës së lartë jouniversitare. Objekti i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Departamenti, si rregull, ndahet në seksione, në të cilat përfshihen disiplinat më të përafërta të një shkence.

Departamentet e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, që janë pjesë e spitaleve universitare, përbëhen nga shërbimet.

Shërbimi është njësi diagnostike dhe trajtuese themelore e spitaleve universitare, që formohet në bazë të specialitetit dhe/ose në bazë të numrit të shtretërve. Në shërbim kryhet procesi pedagogjik dhe kërkimi shkencor.

Neni 12

(Ndryshuar me ligjin nr. 9447, datë 24.11.2005)

Në strukturat e njësive të shkollave të larta përfshihen institutet, qendrat dhe sektorët kërkimorë, laboratorët dhe atelietë mësimore, klinikat, shërbimet mjekësore universitare, studiot, bibliotekat, qendrat sportive, muzetë, fermat eksperimentale, që funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme përkatëse.

Neni 13

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Kursi i studimit është një fushë studimi në shkollën e lartë, në përfundim të të cilit, nga shkolla e lartë pranë së cilës kryhen studimet, lëshohet diplomë. Sipas natyrës

akademike, kursi i studimit mund të emërohet “degë” apo “profil”. Profili është nëndegëzim, me një orientim studimi me të ngushtë dhe më specifik se dega.

Kursi i studimit hapet me vendim të senatit të shkollës së lartë, pasi të jetë marrë miratimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për plotësimin e stadardeve të vendosura prej saj. Efektet ekonomike të hapjes së kursit të ri përballohen nga shkolla e lartë. Shteti, në buxhetin që i cakton shkollës së lartë publike, merr parasysh ekzistencën e kursit të ri vetëm pasi ta ketë njohur nëpërmjet procedurave të akreditimit.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton emërtimin e diplomave që lëshojnë shkollat e larta për ato kurse studimi të njohura nëpërmjet procesit të akreditimit. Për shkollat e larta ushtarake ose të policisë këtë të drejtë e ushtron ministri përkatës.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton formën dhe përmbajtjen e diplomës dhe të shtojcës së diplomës, që lëshohen nga shkollat e larta.

Hapja e departamenteve dhe e seksioneve bëhet me vendimin e senatit të shkollës së lartë, pasi të jetë marrë miratimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për plotësimin e stadardeve të vendosura prej saj. Efektet ekonomike të hapjes së tyre përballohen nga shkolla e lartë. Shteti, në buxhetin që i cakton shkollës së lartë publike, merr parasysh ekzistencën e këtyre njësive të reja vetëm pas rezultatit të vlerësimit institucional dhe akreditimit të shkollës së lartë .

Këtyre kritereve i nënshtrohen edhe hapja e atyre strukturave e njësive të parashikuara në nenin 12, të cilat përballohen nga buxheti i shkollës së lartë.

Mbyllja e kurseve të studimit, e departamenteve dhe e seksioneve bëhet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, pasi është dhënë vlerësimi nga Këshilli i Akreditimit.

Hapja e shkollave të larta universitare, shkollave të larta jouniversitare, fakulteteve, strukturave e njësive të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, të cilat nuk mund të përballohen nga fondi i shkollës së lartë , bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ose të ministrive përkatëse për shkollat e larta ushtarake ose të policisë.

Mbyllja e institucioneve publike të përcaktuara në nenin 13 paragrafi 7 të këtij ligji, bashkimi i tyre, ndryshimi i misionit etj., bëhet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës ose të ministrive përkatëse për shkollat e larta ushtarake ose të policisë, pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit të Akreditimit.

Kriteret, mënyra e funksionimit dhe procedurat për dhënien e lejes për hapjen e shkollave të larta jopublike përcaktohen me këtë ligj dhe me akte nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave për zbatimin e tij. Leja për hapjen e një shkolle të lartë jopublike jepet jo më parë se 6 muaj pas datës së depozitimit të kërkesës në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe jo më vonë se një vit nga data e depozitimit të saj në këtë ministri.

Në shkollat e larta ushtarake ose të policisë, kursi i studimit hapet me miratimin e ministrisë përkatëse. Përcaktimi i strukturës mësimore dhe organike të çdo shkolle të tillë bëhet në varësi të arsimit që jepet dhe miratohet nga titullari i ministrisë përkatëse.

Neni 14

Në sistemin e arsimit të lartë funksionon Konferenca e Rektorëve, si organ kolegjal autonom i rektorëve dhe i drejtorëve të shkollave të larta. Anëtar i Konferencës së Rektorëve është edhe një përfaqësues i autorizuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Konferenca e Rektorëve diskuton për problemet themelore të arsimit të lartë. Detyrat dhe

kompetencat e Konferencës së Rektorëve burojnë nga ky ligj, si dhe nga statutet dhe rregulloret e brendshme të shkollave të larta. Organizimi dhe veprimtaria e Konferencës së Rektorëve përcaktohen në statutin e saj të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 15

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003; shfuqizuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 9387, datë 4.5.2005)

Senatet dhe këshillat në shkollat e larta janë organe kolegjiale, të zgjedhura, që vendosin për problemet më të rëndësishme të shkollës së lartë në fushën e mësimi, kërkimit shkencor dhe në atë administrativo-financiare. Këto organe mbledhen periodikisht.

Senati është organi më i lartë i shkollës së lartë universitare; këshilli i fakultetit është organi më i lartë i fakultetit; këshilli i shkollës është organi më i lartë i shkollës së lartë jouniversitare dhe këshilli i departamentit është organi më i lartë i departamentit.

Përbërja, detyrat, kompetencat dhe funksionimi i senateve dhe i këshillave përkatëse përcaktohen në statutet e shkollave të larta dhe në rregulloret e tyre të brendshme.

Neni 16

(Shfuqizuar togfjalësh dhe shtuar togfjalësh me ligjin nr. 9387, datë 4.5.2005)

Autoritetet drejtuese të shkollave të larta civile e ushtarake dhe të strukturave të njëjseve të tyre përbërëse janë:

- a) Rektori për shkollën universitare.
- b) Drejtori për shkollën jouniversitare.
- c) Dekani për fakultetin.
- ç) Përgjegjësi për departamentin.
- d) Për shkollat e larta të policisë, autoriteti drejtues, i barazvlefshëm me rektorin, drejtorin apo dekanin mund të jetë komandanti apo drejtori.

Në rast mungese, autoritetet ia delegojnë të gjitha kompetencat ose një pjesë të kompetencave zëvendësve të tyre.

Detyrat dhe kompetencat e këtyre autoriteteve drejtuese burojnë nga ky ligj dhe përcaktohen me hollësi në statutet e shkollave të larta.

Neni 17

(Ndryshuar paragrafi i tretë, i katërt dhe i pestë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Shkolla e lartë publike zgjedh organet dhe autoritetet e veta drejtuese.

Departamenti zgjedh, me shumicë votash, përgjegjësin e departamentit, anëtarë të këshillit të departamentit si dhe përfaqësuesit për në këshillin e fakultetit ose të shkollës së lartë jouniversitare.

Këshilli i fakultetit ose i shkollës së lartë jouniversitare përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga departamentet, nga personeli joakademik dhe nga studentët. Këshilli i fakultetit ose i shkollës së lartë jouniversitare (në rastin kur shkolla jouniversitare është strukturë e universitetit) zgjedh, me shumicë votash, përfaqësuesit e vet në senatin e

shkollës së lartë universitare.

Senati i shkollës së lartë universitare përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga këshillat e fakulteteve e të shkollave të larta jouniversitare dhe nga studentët.

Dekani i fakultetit zgjidhet nga personeli akademik i brendshëm, nga përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët e këtij fakulteti.

Rektori i shkollës së lartë universitare ose drejtori i shkollës së lartë jouniversitare zgjidhet nga personeli akademik i brendshëm, nga përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët. Përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët, që votojnë për zgjedhjen e rektorit, janë po ata që votojnë për zgjedhjen e dekanit.

Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë. Procedurat dhe kriteret për pjesëmarrje në zgjedhjet e të gjitha kategorive të punonjësve të shkollave të larta dhe të studentëve përcaktohen në rregulloren për zgjedhjet në shkollat e larta, që miratohet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës. Kjo rregullore, dita e fillimit të zgjedhjeve dhe afatet e realizimit të tyre, në të gjitha shkollat e larta, shpallen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

Pas mbarimit të zgjedhjeve, Presidenti i Republikës emëron rektorin ose drejtorin e zgjedhur (në rastin kur shkolla jouniversitare është jashtë strukturës së Universitetit). Zëvendësrektori dhe zëvendësdrejtori propozohen, përkatësisht, nga rektori ose drejtori dhe emërohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Rektori emëron dekanin e zgjedhur dhe zëvendësdekanin e përzgjedhur nga dekanin. Përgjegjësi i zgjedhur i departamentit emërohet nga dekanin.

Neni 18

(Shtuar paragrafë me ligjin nr. 9447, datë 24.11.2005)

Rektori është njëkohësisht kryetar i senatit, drejtori është kryetar i këshillit të shkollës së lartë jouniversitare dhe dekanin është kryetar i këshillit të fakultetit.

Përgjegjësi i departamentit në shkollën e lartë publike ka të drejtën e përzgjedhjes së përgjegjësve të seksioneve, mbi bazën e konkurimit me dosjen personale. Emërimi i përgjegjësit të seksionit bëhet nga dekanin. Përgjegjësit e seksioneve, anëtarët e zgjedhur të këshillit të departamentit së bashku me përgjegjësin e departamentit, përbëjnë këshillin e departamentit. Përgjegjësi i departamentit është kryetar i këshillit të departamentit.

Në ato departamente të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të cilat janë pjesë e spitaleve universitare, përgjegjësi i departamentit përzgjedh për përgjegjës shërbimi, nga stafi pedagogjik i departamentit, ndër kandidatët me kualifikimin shkencor më të lartë. Ai i propozon drejtorit të spitalit universitar 2 kandidatura për çdo shërbim. Drejtori i spitalit universitar emëron përgjegjësit e shërbimeve në departamentet spitalore të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, pasi të ketë marrë miratimin me shkrim të Dekanit të Fakultetit.

Mosmarrëveshjet për emërimin, të parashikuara në paragrafin e mësipërm, zgjidhen nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Këshilli i departamentit përbëhet nga përgjegjësi i departamentit, përgjegjësit e shërbimeve dhe anëtarët e zgjedhur.

Neni 19

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003; ndryshuar numër me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Autoritetet drejtuese të shkollave të larta publike zgjidhen çdo katër vjet. Ata nuk mund të zgjidhen radhazi në të njëjtin funksion më shumë së dy herë.

Senati dhe këshillat zgjidhen çdo 4 vjet.

Neni 20

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Autoritetet drejtuese të shkollave të larta duhet të kenë gradë dhe tituj shkencorë. Në statutin e secilës prej shkollave të larta përcaktohen grada dhe titujt që duhet të kenë autoritetet sipas nenit 16, si dhe anëtarët akademikë të këshillave dhe të senatit.

KREU III

MARRËDHËNIET FINANCIARE DHE ADMINISTRATIVE

Neni 21

Shkollat e larta publike janë institucione buxhetore. Ato financohen nga buxheti i shtetit sipas ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas akteve nënligjore në zbatim të tij. Buxheti i çdo shkolle të lartë është zë më vete në buxhetin për arsimin.

Fakultetet, në rastin kur plotësojnë standardet e caktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave, kanë llogari më vete.

Neni 22

Shkolla e lartë e detajon buxhetin sipas rektoratit, fakulteteve, departamenteve ose njësive të tjera të përcaktuara në nenin 12. Të gjitha këto njësi janë autonome në administrimin e këtij buxheti, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Për të gjitha njësitë, veprimet e llogarisë kryhen nëpërmjet administratës së shkollës së lartë, përveç rasteve kur njësitë kanë llogari më vete.

Neni 23

Fondet për kërkimin shkencor përcaktohen si zë më vete në buxhetin e çdo shkolle të lartë. Këto fonde administrohen nga shkolla e lartë në formë pagese për normën shkencore, si dhe për pajisjen e laboratorëve apo për shpenzime të tjera të lidhura me veprimtarinë shkencore.

Neni 24

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Shkollat e larta, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, krijojnë dhe

përdorin të ardhurat që realizojnë gjatë veprimtarisë së tyre.

Tarifat e shkollimit për shkollat e larta publike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përdoren nga shkollat e larta, pasi shlyhen detyrimet ndaj shtetit në masën jo më shumë se 10 për qind.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës kryen kontrollin dhe revizionin ekonomiko-financiar të shkollave të larta publike, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Arsimimi në shkollat e larta ushtarake ose të policisë është falas.

Arsimimi i ushtarakëve dhe i punonjësve të Policisë së Shtetit në shkollat e larta civile, në sistemin e shkollimit, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, është pjesë e arsimimit të tyre të plotë, që kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji. Shpenzimet për këtë arsimim përballohen nga Ministria e Mbrojtjes për ushtarakët dhe nga Ministria e Rendit Publik për punonjësit e Policisë së Shtetit.

Neni 25

Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton strukturën orientuese të administratës së shkollave të larta në të gjitha nivelet.

Personat përgjegjës për mbarrëvajtjen administrative dhe ekonomike të shkollës së lartë janë kancelari i shkollës së lartë dhe kancelarët e fakulteteve, të cilët janë specialistë me formim të lartë ekonomik dhe me përvojë menaxhuese.

Kancelari i shkollës së lartë publike universitare apo jouniversitare propozohet, përkatësisht, nga rektori ose drejtori dhe emërohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Kancelari i fakultetit propozohet nga dekani dhe emërohet nga rektori.

Detyrat dhe kompetencat e kancelarëve përcaktohen në statutin e shkollës së lartë.

KREU IV PERSONELI I SHKOLLAVE TË LARTA

Neni 26

Personeli i shkollave të larta përbëhet nga:

- a) personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm;
- b) personeli ndihmës mësimor-shkencor;
- c) personeli administrativ;
- ç) personeli bibliotekar;
- d) personeli i shërbimit.

Detyrat dhe të drejtat e personelit të shkollave të larta, që burojnë nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen në statutin e shkollës së lartë dhe në rregulloren e brendshme të njësive përbërëse të shkollës, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 27

Komisioni i Kualifikimit Shkencor, i ngritur nga Këshilli i Ministrave, miraton klasifikimin për personelin akademik në shkollat e larta.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës vendos për numrin e vendeve të punës për personelin akademik, si dhe për klasifikimin dhe numrin e vendeve të punës për personelin

administrativ, bibliotekar dhe të shërbimit të shkollave të larta publike civile. Për shkollat e larta ushtarake ose të Policisë vendosin ministritë përkatëse.

Vendet e punës për punonjësit e brendshëm akademikë, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ dhe atë bibliotekar fitohen me konkurs dhe mbi bazën e kontratës së punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutet e shkollave të larta dhe rregulloret e veçanta të tyre.

Neni 28

(Shtuar fjali me ligjin nr. 9206, datë 17.6.2004)

Në shkollën e lartë publike personeli akademik i brendshëm është i detyruar të shërbejë, duke qenë i zënë me punë të paktën deri në kufirin minimal të normës mësimor-shkencore vjetore. Personeli akademik i brendshëm me titullin “Profesor” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, lirohet nga detyra për arsye të plotësimit të moshës së pensionit, sipas neneve 31 dhe 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.2003 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kjo dispozitë ka efekt vetëm për subjektet e mësipërme që kanë mbushur moshën e pensionit, por jo mbi 68 vjeç. Në rastet kur ndërmjet shkollave të larta shqiptare, ndërmjet tyre dhe shkollave të larta të huaja ose institucioneve kërkimore-shkencore, vendase apo të huaja, nënshkruhen marrëveshje për shkëmbim personeli akademik, norma minimale mund të realizohet në më shumë së një institucion.

Normat mësimor-shkencore caktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Për të plotësuar nevojat e realizimit të procesit mësimor-shkencor, shkolla e lartë kërkon punonjës të jashtëm akademikë, me kontratë me afate të ndryshme. Mënyrat e trajtimit të punonjësve të jashtëm të shkollave të larta publike caktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Këshilli i Ministrave përcakton numrin e orëve mësimore të papaguara nga buxheti i shkollave të larta, që një punonjës i institucioneve shkencore, në varësinë e Akademisë së Shkencave, është i detyruar të kryejë në shkollat e larta. Kjo ngarkesë mësimore është pjesë përbërëse e detyrës funksionale për të cilën këta punonjës paguhën nga Akademia e Shkencave.

Kriteret e përzgjedhjes së këtyre specialistëve përcaktohen me një rregullore të përbashkët, të nxjerrë nga shkolla e lartë dhe Akademia e Shkencave.

Neni 29

Shkolla e lartë funksionon në bazë të këtij ligji, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të statutit dhe rregulloreve të brendshme.

Statuti i shkollës së lartë hartohet, përkatësisht, nga senati i universitetit apo këshilli i shkollës së lartë dhe miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Statuti i shkollave të larta ushtarake ose të policisë miratohet nga ministri përkatës. Rregullorja e zgjedhjeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese hartohet nga senati ose këshilli i shkollës së lartë dhe miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Rregullorja e brendshme e fakultetit miratohet nga rektori. Rregullorja e brendshme e departamentit miratohet nga dekani i fakultetit ose drejtori i shkollës së lartë jouniversitare. Këto rregullore hartohen nga këshillat përkatës.

Në zbatim të këtij ligji, statutet e shkollave të larta paraqiten për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës jo më vonë se tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligj. Në qoftë se brenda një muaji nga data e paraqitjes për miratim, Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk shprehet mbi këtë statut, ai konsiderohet i miratuar.

Neni 30

Personeli akademik i shkollave të larta ka të drejtë që, çdo 7 vjet, të kualifikohet, specializohet ose të kryejë jashtë shtetit veprimtari akademike në fushën përkatëse, për një periudhë kohe deri në një vit.

Kjo kohë mund të realizohet si e tërë gjatë një viti akademik ose në periudha të shkëputura.

Kriteret e mësipërme nuk zbatohen në rastet e studimeve të plota pasuniversitare jashtë shtetit, të cilat realizohen në përputhje me planet e kualifikimit të miratuara nga këshilli i fakultetit, në bazë të propozimit të departamenteve përkatëse.

Në të gjitha rastet nënshkruhet një kontratë e posaçme me shkollën e lartë, sipas mënyrave që përcaktohen në statutin e saj.

KREU V STUDENTËT

Neni 31

(Ndryshuar paragrafi i parë, fjalë dhe fjali me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003; ndryshuar paragrafët 1, 2, 4 dhe 5 dhe shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Pranimet në shkollat e larta publike bëhen në bazë të kuotave. Kuotat e pranimi për sistemin e studimeve me kohë të plotë propozohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Kuotat për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme, në distancë, si dhe i formave të tjera të studimit përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Për këto kuota zbatohen tarifa të veçanta shkollimi, të cilat caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave.

Për përcaktimin e kuotave dhe të tarifave të shkollimit merret edhe mendimi i shkollave të larta.

Kuotat e pranimi për shkollat e larta ushtarake ose të policisë propozohen nga ministritë përkatëse dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Pranimet në shkollën e lartë publike bëhen me konkurrim. Mënyra e konkurrimit përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kur numri i kandidatëve të regjistruar është më i vogël se kuota e parashikuar, pranimet janë të hapura.

Pranimi i studentëve në shkollat e larta bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, sipas kuotave të miratuara.

Pranimi i studentëve të huaj në shkollat e larta publike të Republikës së Shqipërisë bëhet në bazë të kuotave që miraton Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Kriteret e pranimi përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 32

(Shtuar paragrafë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003; ndryshuar paragrafi I fundit dhe shtuar paragraf me ligjin nr. 9387, datë 4.5.2005)

Studenti njihet i tillë me regjistrimin në shkollën e lartë dhe e humbet emrin student me marrjen e diplomës ose të dëshmisë ose me përjashtimin nga shkolla e lartë. Të drejtat dhe detyrimet e studentit përcaktohen në statutin e shkollës së lartë, në të cilën bën pjesë.

Studentët kanë të drejtë:

a) të përdorin të gjitha instalimet dhe pajisjet e shkollës së lartë për plotësimin e punës së tyre mësimore-shkencore, në përputhje me programet dhe rregullat përkatëse.

b) të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha këshillat e shkollës, duke përfshirë edhe senatin, në përputhje me mundësitë e përfaqësimit, të përcaktuara në statutin e shkollës së lartë.

c) të përfitojnë bursë studimi, kur përmbushin kushtet e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Studentët e shkëlqyer marrin bursë dhe shpërblime të veçanta, që administrohen nga shkolla e lartë. Bursat për studentët e shkëlqyer përballohen nga shteti, me fondet e veçanta që u jepen shkollave të larta, kurse shpërblimet përballohen nga vetë shkolla e lartë, nga të ardhurat që realizon ajo, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

Studentët në çdo shkollë të lartë universitare zgjedhin qeverinë studentore.

Studentët pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik, që përdoret nga të gjithë studentët e arsimit të lartë publik e jopublik me kohë të plotë, me anë të së cilës studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara. Organi përgjegjës për lëshimin e këtij dokumenti është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Karta e studentit ka të njëjtat parametra për të gjitha universitetet në Republikën e Shqipërisë. Çmimi, forma, përmbajtja, elementet e sigurisë dhe procedurat për pajisjen me kartën e studentit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Studentët pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik, që përdoret nga të gjithë studentët e arsimit të lartë publik e jopublik me kohë të plotë, me anë të së cilës studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara. Organi përgjegjës për lëshimin e këtij dokumenti është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Karta e studentit ka të njëjtat parametra për të gjitha universitetet në Republikën e Shqipërisë. Çmimi, forma, përmbajtja, elementet e sigurisë dhe procedurat për pajisjen me kartën e studentit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33

Studentët e shkollave të larta kanë të drejtë të organizohen në shoqata studentore jopolitike.

Krijimi, organizimi, funksionimi dhe shpërndarja e shoqatave studentore në shkollat e larta bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Neni 34

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për kujdesin dhe ndihmën ndaj studentëve të shkollave të larta për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrimeve të tyre, krijon një sektor të

informacionit studentor.

KREU VI STUDIMET NË SHKOLLAT E LARTA

Neni 35

(Ndryshuar paragrafi I parë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003; ndryshuar paragrafët 1 dhe 2 me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Sistemi i studimeve në shkollat e larta është me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, në distancë, si dhe në çdo formë tjetër ndërthurjeje të këtyre formave. Mënyra dhe kriteret përcaktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës me akte nënligjore.

Studimet në shkollat e larta kryhen në vite akademike. Në shkollat e larta universitare studimet janë të organizuara në cikle studimi. Cikli i parë i studimeve zgjat, të paktën, 3 vite akademike, me një ngarkesë mësimore prej jo më pak se 60 kredite ECTS (Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve) në vit. Në përfundim të ciklit të parë të studimeve studentët marrin diplomë “Bachelor” dhe shtojcën e diplomës. Cikli i dytë i studimeve, që është vazhdim i ciklit të parë, zgjat 1-2 vite akademike, me një ngarkesë mësimore prej jo më pak se 60 kredite ECTS në vit. Në përfundim të ciklit të dytë të studimeve, studentët marrin diplomë “Master”. Diploma shoqërohet me listën e notave, e cila pasqyron kualifikimin e studentit, sipas vlerësimit kombëtar dhe atij në kredite. Organizimi i ciklit të dytë të studimeve “Master” bëhet me të njëjtat procedura, si ato të përcaktuara në paragrafin e shtatë dhe të tetë të nenit 13 të ligjit.

Në shkollat e larta jouniversitare studimet zgjasin 2 vite akademike. Studenti, në përfundim të tyre, merr diplomën përkatëse.

Për shkollat e larta jouniversitare kjo kohëzgjatje nuk është më e vogël se dy vjet akademikë.

Kohëzgjatja e plotë e studimëve në shkollat e larta ushtarake ose të policisë është jo më pak se tre vjet akademikë. Për kandidatin që pranohet pas përfundimit të një shkollë të lartë civile, kjo kohëzgjatje është jo më pak se një vit akademik.

Neni 36

Shkollat e larta funksionojnë në bazë të planeve mësimore, që hartohen prej tyre dhe miratohen nga senati ose këshilli i shkollës së lartë.

Programet mësimore hartohen nga çdo lektor ose grup lektorësh, shqyrtohen në mbledhjen e seksionit ose të departamentit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.

Neni 37

Arsimimi pasuniversitar është hallkë e sistemit të arsimit të lartë dhe organizohet pranë shkollave të larta. Ai përfshin kualifikimin shkencor pasuniversitar, kurset e specializimit dhe kurset e kualifikimit afatshkurtër e afatgjatë.

Neni 38

(Ndryshuar togfjalësh dhe shtuar paragraf me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003; ndryshuar paragrafët 1 dhe 2 me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Kualifikimi shkencor pasuniversitar realizon përgatitjen e specialistëve, të aftë për të kryer veprimtari kërkimore-shkencore. Kualifikimi shkencor pasuniversitar kryhet pranë shkollave të larta universitare dhe përfundon me dhënien e gradës shkencore “doktor i shkencave”.

Hapja dhe mbyllja e shkollës pasuniversitare bëhet me të njëjtat procedura, të përcaktuara në paragrafin e shtatë dhe të tetë të nenit 13 të ligjit.

Fondet për organizimin dhe funksionimin e shkollave pasuniversitare publike përballohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera financiare, sipas legjislacionit në fuqi.

Studimet për doktoraturë kryhen pranë shkollës së lartë universitare, ku është hapur shkolla pasuniversitare. Të drejtën për ndjekjen e këtyre studimeve e kanë vetëm personat që kanë marrë “Master” apo diploma të tjera, të huaja, të barazvlefshme me të.

Studimet për të marrë diplomën e shkollës pasuniversitare dhe për doktoraturë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kryhen në Akademinë e Mbrojtjes, ndërsa në fushën e rendit dhe të sigurisë publike kryhen në Akademinë e Policisë.

Personat që ndjekin shkollën pasuniversitare apo doktoraturën, gëzojnë të drejtat dhe u nënshtrohen detyrimeve të studentëve, të përcaktuara në kreun V të këtij ligji, si dhe në statutin dhe rregulloret e brendshme të shkollës së lartë universitare përkatëse.

Neni 39

Kurset e specializimit dhe të kualifikimit afatshkurtër e afatgjatë hapen pranë shkollave të larta, në përputhje me kriteret e parcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 40

(Ndryshuar paragrafi I parë dhe shtuar togfjalësh me ligjin nr. 9387, datë 4.5.2005)

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik kryejnë kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në shkollat e larta përkatëse.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik ka të drejtë të shfuqizojë çdo akt të nxjerrë nga senati i shkollës së lartë universitare, nga këshilli i shkollës së lartë jouniversitare, rektori ose drejtori i tyre, në rastet kur këto akte janë në kundërshtim me ligjin.

Rektori shfuqizon vendimet e dekanit apo të këshillit të fakultetit, kur këto bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e konflikteve ndërmjet tyre çështja ankimohet në gjykatën e apelit.

Në raste flagrante, kur me veprimet e tyre rektori apo drejtori shkelin, në mënyrë të përsëritur, aktet ligjore, nënligjore, statutin apo rregulloren e shkollës së lartë, Ministri

i Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik thërret zgjedhjet e parakohshme për rektorin apo drejtorin e ri, pasi merr paraprakisht mendimin e senatit. Në raste të tilla të njëjta, rektori thërret zgjedhjet e parakohshme për dekanin apo drejtorin e ri, kurse dekanin apo drejtorin thërret zgjedhjet e parakohshme për përgjegjësin e ri të departamentit, pasi merr paraprakisht mendimin e këshillave përkatës.

Neni 41

Çdo shkollë e lartë harton projektstatutin e vet, në përputhje me këtë ligj dhe me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, e cila kujdeset për harmonizimin e këtyre projektstatuteve mbi një trung të përbashkët, duke pasur parasysh edhe specifikat e çdo shkolle të lartë.

Neni 42

Shtetasve të Republikës së Shqipërisë, kur plotësojnë kushtet për të ndjekur studimet e larta, u njihet e drejta të studiojnë e të diplomohen në më shumë se një fushë studimi pranë shkollave të larta. Këto të drejta realizohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në statutet e shkollave të larta.

Neni 43

Mënyrat e njohjes dhe të ekuivalentimit të certifikatave, diplomave dhe gradave të fituara në shkolla të larta të huaja bëhen me akte të Këshillit të Ministrave, duke respektuar marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Neni 44

Çdo shkollë e lartë ka të drejtë të zgjedhë emrin zyrtar dhe stemën e vet.

Emri zyrtar dhe stema e shkollës së lartë, të zgjedhura nga shkolla e lartë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës ose Ministrisë së Mbrojtjes ose të Ministrisë së Rendit Publik, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 44/1

(Shtuar me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006)

Zgjedhjet e para për afatin e ri katërvjeçar për autoritetet dhe organet drejtuese në shkollat e larta shpallen menjëherë me fillimin e vitit të ri akademik, në vitin kur mbaron afati trevjeçar i zgjedhjeve të fundit.

Autoritetet dhe organet drejtuese, të zgjedhura për mandatin 3-vjeçar, vazhdojnë detyrën deri në zgjedhjen e autoriteteve dhe të organeve të reja drejtuese në shkollat e larta.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përgatisë dhe të paraqesë për miratim në Kuvend projektligjin, ku të përcaktohen edhe mënyrat dhe procedurat për zhvillimin e zgjedhjeve, të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 45

Ligji nr.7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet e tij, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe aktet nënligjore, që lidhen me arsimin e lartë e që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 46

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2331, datë 8.3.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani